



UNMIK



INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA

QEVERIA E KOSOVËS – GOVERNMENT OF KOSOVO – VLADA KOSOVA

Komisioni Qendror Ndërmintor – Grupi Punues
Central Inter-Ministerial Commission – Working Group
Centralna Medjuministarska Komisija – Radna Grupa

RAPORT PROGRESI

Prishtinë,
01.06.2004

PËR VLERËSIMIN E DËMEVE NËPËR KOMUNA TË SHKAKTUARA GJATË TRAZIRAVE TË
17-18 MARSIT 2004 DHE ECURINË E PUNËVE TË DERITANISHME PËR RENOVIMIN E TYRE

KOMUNA E MITROVICËS

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
7	18	75	35	135

Të dorëzuara për proqes të tenderimit: **2 Tendera nga 15 shtëpi kat. II(7), III(22), IV (1), Gjithsej 30 shtëpi**(më vonë është bërë ndarja në tre tendera).

Është kryer vlerësimi nga komisioni i caktuar dhe është bërë shpallja e kompanive fituese, si dhe janë nënshkruar kontratat me që të tri kompanitë.

Kompania “FITIMI” nga Mitrovica, për 15 shtëpi 99 639.63 €

Kompania “BASHKIMI” nga Prishtina për 7 shtëpi 64 259.54 €

Kompania “EXKOS” nga Zubin Potoku për 8 shtëpi 40 738.31 €

Fillimi i punëve për rehabilitimin e këtyre shtëpive ka filluar të Martën me datën 01/06/2004.

Komuna është zotuar që për të gjitha shtëpitë edhe të Kategorisë IV dhe V do të përgaditet dokumentacioni për tenderim nga vet Komuna.

KOMUNA E FERIZAJT

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
0	0	4(Familje në një Barakë) +1 Shtëpi Gjithsej 5	5	10

Është sjellë dokumentacioni për proqes të tenderimit për të gjitha shtëpitë (10) dhe është bërë shpallja në gazetë. Hapja e ofertave është bërë me datën 01/06/2004, ndërsa sot me datën 02/06/2004 do të fillon vlerësimi i ofertave.

KOMUNA E KLINËS

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
3	0	1	0	4

Janë hapë ofertat para tri javësh dhe njëra nga kompanitë ka fituar ofertën (vlera 11 763.00 €).
Ka paqartësi-ngecje lidhur me zotimin e mjeteve.

Pritet raporti nga Komuna lidhur me punët e mëtejme (gjendjen më të re).

KOMUNA E VUSHTRRIË

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
0	12	42	29	83

Për **8 shtëpi të kategorisë së III** është kryer vlerësimi i tenderit, është bërë shpallja e fituesit dhe është nënshkruar Kontrata me kompaninë fituese “MAK BUILDING” nga Vushtrria në vlerë 18 690.52 €.

Punët për rehabilitimin e këtyre 8 shtëpive të dëmtuara kanë filluar të Hënën me datën 24/05/2004.

Dokumentacioni për proqes të tenderimit edhe për **4 shtëpi të Kat.III** është dorëzuar të Martën me datën 25/05/2004 dhe pritet shpallja në gazetë.

- **Objektet tjera të kat. IV(42) dhe V(29) gjithsej 71, do të rindërtohen përmes OJQ-ve.**

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

Dëmet sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
37	7	69	17	130

Të kryera 24 banesa kolektive të kat. II (janë disa vërejtje, të cilat kanë mbetë që të përmirësohen).

Të dorëzuara për proqes të tenderimit: **10 shtëpi Kat.III(1), Kat. IV(7), Kat.V(2)**

Është kryer vlerësimi i tenderit, është bërë shpallja e fituesit dhe është nënshkruar Kontrata me kompaninë fituese, NN “Stublla” nga Lipjani, në vlerë **131.963,90 €**.

Punët për rehabilitimin e shtëpive të dëmtuara kanë filluar të Hënën me datën 24/05/2004.

Për 19 shtëpi të Kategorisë së II^{të} dhe III^{të} zyrtarët Komunal janë zotuar që do të dorëzojnë dokumentacionin për proqes të tenderimit të Enjten me datën 27/05/2004, mirëpo për shkak të jokompletimit nga ana e zyrtarëve komunal, kjo datë është shtyer për 01/06/04.

- **Shtëpitë e kat. IV(62) dhe V(15) Gjithsej 77, do të rindërtohen përmes OJQ-ve.**

KOMUNA E LIPJANIT

Dëmet sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
6	4	23	2	35

Të dorëzuara për proqes të tenderimit 10 shtëpi, më 14/05/04.prej tyre 6 shtëpi të Kat.II dhe 4 shtëpi të Kat. III. Tenderi është shpallë në gazetë më 22/05/04, dhe është në fazën e vlerësimit.

Shtëpitë tjera të kat. IV(23) dhe V(2) gjithsej 25, do të rindërtohen përmes OJQ-ve.

KOMUNA E OBILIQIT

Dëmet sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
76	39	37	49	201

Të kryera 48 banesa kolektive të kat. II nga Komuna (llogaria 8 900 €).

Të kryera 22 banesa kolektive të kat. II nga GOAL-i (OJQ).

Tenderi i dorëzuar për 22 banesa kolektive të kat.III me datën 24/05/2004(është bërë shpallja në gazetë me datën 28/05/04.)

Tenderi i dorëzuar për 12 banesa kolektive të kat.III me datën 24/05/2004(është bërë shpallja në gazetë me datën 28/05/04).

Tenderi i dorëzuar për 11 shtëpi të kat.II dhe III me datën 24/05/2004.(është bërë shpallja në gazetë me datën 28/05/04).

Është bërë nënshkrimi për vlerësim e dëmeve nga të gjithë pronarët.

- **Shtëpitë e kat. IV(37) dhe V(49) Gjithsej 86, do të rindërtohen përmes OJQ-ve.**

KOMUNA E PODUJEVËS

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
0	0	1	0	1

Ofertimi është bërë nga vet Komuna.

Punët për rehabilitimin e kësaj shtëpie kanë përfunduar, pritet raporti nga KK-Podujevë.

KOMUNA E PRISHTINËS

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
91	3	8	1	103

Të kryera 92 banesa, në Lagjën “Ulpiana”-YU Program, prej tyre 90 banesa të kat.2 dhe 2 banesa kat.3.

Tenderi për 11 shtëpi kat.II -1, kat.III -1, kat.IV -8, kat.V -1 është dorëzuar nga Komuna me 24/05/2004, ndërsa është dorëzuar Prokurimit më 25/05/04.

Tenderi është shpallë në shtyp më 26/05/04, dhe data e mbylljes është paraparë të jetë me datën 03/06/04, mirëpo për shkaqe të përkthimit të dobët dhe gabimeve në gjuhën serbe (të paramasës), mbyllja e këtij tenderi është shtyer gjerë më datën 07/06/04, ndërsa data e vizitës për ofertuesit në objekte është caktuar të jetë 04/06/04. Kjo shtyrje është publikuar në shtypin ditor më 01/06/04.

KOMUNA E SHTIMES

Dëmet sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
2	0	3	6	11

Përgaditja e dokumentacionit për tenderim nga Komuna është kryer për të gjitha shtëpitë, pritet që të bëhet shpallja në gazetë.

Zyrtarët e kësaj Komune kanë probleme me sigurimin e nënshkrimeve nga pronarët për shkak se nuk janë duke jetuar në këtë komunë. Për këtë janë lajmëruar përfaqësuesit e UNMIK-ut, të cilët kanë premtuar që do ti sigurojnë nënshkrimet.

KOMUNA E KAMENICËS

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
29	0	0	0	29

Procedura e përzgjedhjes së ofertave është kryer nga Komuna.

Pritet raporti nga Komuna për përfundimin e punëve për rehabilitimin e të gjitha shtëpive.

KOMUNA E GJAKOVËS

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
0	1	0	2	3

Është sjellë dokumentacioni për tenderim dhe pas disa vërejtjeve për plotësimin dhe kompletimin më të detajuar të dokumentacionit, Komuna është zotuar që gjatë kësaj jave tenderi do të përgaditet dhe do të shpallet në gazetë (për të 3 shtëpitë).

KOMUNA E PRIZRENIT

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
0	0	10	44	54

Është dorëzuar dokumentacioni për tenderim për 4 shtëpi Kat.IV(2) Kat.V(2), pritet që shpallja e tenderit në gazetë të bëhet gjatë kësaj jave.

*****Shtëpitë tjera të Kat. IV dhe V (50) – Rastet e Nënkalasë trajtim i vaçant.**

KOMUNA E VITISË

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
32	5	1	4	43

Të kryera 32 shtëpi të Kat. II.

Të dorëzuara për proqes të tenderimit: **5 shtëpi të Kat. II**, nga Komuna është sjellë dokumentacioni për tenderim dhe pritët që shpallja e tenderit në gazetë të bëhet gjatë kësaj jave.

Gjithashtu edhe për pjesën tjetër të shtëpive të Kat. së IV dhe V Komuna ka premtuar që vet do ta përgadisë dokumentacionin për tenderim.

KOMUNA E RAHOVECIT

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
7	0	0	0	7

Oferimi është bërë nga vet Komuna.

Pritët raporti nga Komuna për përfundimin e renovimit për të gjitha shtëpitë e dëmtuara.

KOMUNA E GJILANIT

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
39	3	11	9	62

Sipas Komisionit Komunal të gjitha shtëpitë e kategorisë së II (39) do të shkojnë përmes tri ofertave nga Komuna pasi që vlera e tyre llogaritet që të jetë më pak se 10 000 € . Ndërsa për 3 shtëpi të tjera të kat. III është dorëzuar dokumentacioni për tenderim dhe pritët që shpallja në gazetë të bëhet gjatë kësaj jave.

Gjithashtu edhe për pjesën tjetër të shtëpive të Kat. së IV dhe V Komuna ka premtuar që vet do ta përgadisë dokumentacionin për tenderim deri në fund të kësaj jave.

KOMUNA E NOVO BËRDËS

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
2	0	0	0	2

Dy zyrtar të MMPH-së me 25/05/2004 kan inspektuar gjendjen në teren për shkak të disa paqartësive me pronarët dhe pritët që dokumentacioni për tenderim dhe shpallje në gazetë të përgaditet edhe për keto dy shtëpi.

KOMUNA E PEJËS

Dëme sipas inqizimit:

Kat. II	Kat. III	Kat. IV	Kat. V	Total
0	0	24	0	24

Është dorëzuar dokumentacionit për tenderim për të gjitha shtëpitë (24) me datën 25/05/2004, ndërsa shpallja në gazetë është bërë me datën 29/05/2004.

Tendera të dorëzuar

KOMUNA		
Fushë Kosovë	10	Shtëpi
Vushtrri	8+4=12	Shtëpi
Ferizaj	10	Shtëpi
Prizren	4	Shtëpi
Gjilan	3	Shtëpi
Lipjan	10	Shtëpi
Viti	5	Shtëpi
Obiliq	22+12=34 +11	Banesa Shtëpi
Prishtina	11	Shtëpi
Peja	24	Shtëpi
Mitrovica	15+7+8=30	Shtëpi
Total	130 +34	Shtëpi Banesa

*****Vërejte: Probleme me nënshkrime nga pronarët për vlerësimin e dëmeve ka gati në të gjitha Komunat.**

Fatmir Azemi
Koordinator i zyreve regjionale,
Grupi punues i Komisionit Qendror Ndër-Ministror